

# DEKLARATË

PRISHTINË, 24.03.2020

Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (**STIKK**), shoqatë kjo e cila në anëtarësi të saj përmbanë kompani private të cilat ofrojnë konsulencë, shërbime dhe produkte të komunikimit dhe të teknologjisë, përmes kësaj shkrese po i drejtohet Institucioneve dhe Ministrive relevante shtetërore për të adresuar nevojat konkrete të sektorit të TIK-ut, për të ndihmuar dhe parandaluar rrezikimin e ekzistencës së kompanive në këtë sektor, pas gjendjes emergjente të krijuar përshkak të **COVID-19**.

Fillimisht duam ta përgëzojmë vendimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për shtyrjen e deklaramëve tatimore deri më 30 qershor, ky vendim është shumë i mirëpritur dhe një bare më pak për drejtuesit e bizneseve në këtë periudhë të vështirë.

Së dyti, propozojmë që Ministrinë tjera të ndjekin po të njëjtin shembull sikurse Ministria e Financave dhe Transfereve (**Vendimi i datës 19.03.2020**)\*1], si dhe të Qeverisë së Shqipërisë (**Vendim i datës: 19.03.2020**)\*2], dhe të ndërmarrin masa të cilat do t'iu ndihmonin drejtuesëve të bizneseve të vazhdojnë veprimtarinë e tyre në çfarëdo forme të improvizuar derisa gjendja emergjente të rikthehet në normalitet. Disa nga propozimet tona të cilat janë vijn nga bregat e komunitetit të TIK-ut në Kosovë, për hapat që duhet ndërmarrur janë:

1. **Të shqyrtohet mundësia për subvencionim të plotë apo pjesshëm të rrogave të punëtorëve gjatë periudhës sa zgjatë gjendja emergjente;**
2. **Të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm me energji elektrike dhe qasje në Internet gjatë periudhës sa zgjatë gjendja emergjente;** (sipas propozimit të zëvendëskryeministrit z. Avdullah Hoti)\*3];
3. **Të aktivizohet klauzola e "Force Majeure" për shpenzime të qeras dhe lizingut, pra të pezullohen ato, derisa vendi është në gjendje emergjente;**
4. **Të pezullohen kamatat e interesit në të gjitha kreditë dhe obligimet kreditore derisa vendi është në gjendje emergjente;**
5. **Të pezullohen pagesat e shërbimeve komunale derisa vendi është në gjendje emergjente;**

[WWW.STIKK.ORG](http://WWW.STIKK.ORG)

+ 383 (0) 38 77 11 80

Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtina  
Kosovo

Ju bëjmë thirrje të gjitha Institucioneve dhe Ministrive ti marrin seriozisht këto propozime pasi që kjo gjendje emergjente e shkaktuar do të ndikoj shumë edhe në ekonominë e vendit tonë dhe do të marr kohë deri në rikthim në normalitet. Masat e propozuara janë masa parandaluese të problemeve shumë më të mëdha që mund të vijin nëse nuk reagojmë me kohë.

Masë e rekomandueshme e menjëhershme pas pikave të përmendura mbetet zhvillimi i programit mbështetës për krijimin e pakove stimuluese financiare për rimëkëmbje. Qeveria të përkushtohet që në bashkëpunim të ngushtë me pëfaqësues të sektorit privat dhe ekspertët e fushës, të zhvillon programin e detajuar të pakos stimuluese financiare për mbështetjen e sektorit privat.

Këto pako stimuluese financiare do të shfrytëzohen në fazën e rimëkëmbjes për:

- 1. Ofrimin e subvencioneve për bizneset për mbulimin e obligimeve operacionale, përfshi pagesën e pagave, qirave dhe shpenzimeve operative në mënyrë që të nxitet rimëkëmbja vetanake sa më shpejtë.**
- 2. Shtimin e kapitalit dhe zhvillimin e produkteve financiare të reja të ofruara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, të cilat duhet të perdoren nga Bankat Komerciale në Kosovë për ofrimin e likuiditetit shtesë përmes produkteve kreditore për bizneset në Kosovë për nxitjen e zhvillimit të biznesit, sidomos të sektorit të shërbimeve të TIK.**
- 3. Zhvillimin e masave të tjera për stimulimin e funksionimit të zinxhirëve të vlerës në sektorët e ndryshëm të ekonomisë.**

Në fund edhe njëherë deshëm që në emër të anëtarëve të **STIKK** të shprehim gatishmërinë e angazhimit dhe të falendrojmë komapnitë anëtare dhe komunitetin që i janë dale në ndihmë pro-bono institucioneve me shërbimet, produktet dhe stafin e tyre për të tejkaluar situatën emergjente të shkaktuar nga **COVID-19**.

Me Respekt,  
**ANËTARËSIA E STIKK**

- \* 1 - <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1277C340-1F3F-4574-A6C2-A6842A0ED1E4.pdf>  
\* 2 - <https://kryeministria.al/newsroom/plani-financiar-per-perballimin-e-pasojave-te-covid-19/>  
\* 3 - <https://www.koha.net/arberi/213407/prezantohen-masat-e-reja-te-qeverise/>

**WWW.STIKK.ORG**  
+ 383 (0) 38 77 11 80  
**Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtina**  
**Kosovo**